



Agjencia për mbikëqyrje të financimit
kapital të sigurimit pensional

BULETINI ELEKTRONIK

E-MAPAS

NR.55

15 SHTATORI DITA E VETËDIJES PENSIONALE
“PENSION PA TENSION – KURSE SOT, KËNAQU EDHE NESËR”

TETOR 2025

15 SHTATORI DITA E VETËDIJES PENSIONALE „PENSION PA TENSION – KURSE SOT, KËNAQU EDHE NESËR“

Në kuadër të shënimit të 15 Shtatorit – Ditës së Vetëdijes Pensionale, Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS) edhe këtë vit zhvilloi një fushatë disa-ditore edukative në disa shkolla të mesme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe një ngjarje përmbyllëse në Shkup.

Qëllimi kryesor i fushatës ishte ngritja e vetëdijes te gjeneratat e reja për rëndësinë e përgjegjësisë personale në planifikimin e së ardhmes dhe vlerën e kursimit në kohë në sistemin pensional.

Nën moton “Pension pa tension – kurse sot, kënaqu edhe nesër”, përmes një sërë ligjëratash, lojërash interaktive, kuize dhe aktivitete edukative, të rinjtë patën mundësi të mësojnë më shumë rreth funksionimit të sigurimit pensional të financuar kapitalisht dhe pse është e rëndësishme të fillohet kursimi që në moshë të re.

Këtë vit u planifikua vizita e disa shkollave të mesme profesionale në qytete të ndryshme të vendit.

9 shtator 2025 – SHM „Cvetan Dimov“ – Shkup

Fushata filloi me ligjëratën në shkollën e mesme “Cvetan Dimov” në Shkup. Ngjarjen e hapi drejtori i shkollës me një fjalë të shkurtër, duke i kujtuar nxënësit se kultura financiare dhe ajo pensionale janë pjesë e rëndësishme e së ardhmes së tyre.

Ligjëratën e mbajtën Pranvera Suma, këshilltare kryesore e Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it, Engin Elmaz, udhëheqës i Sektorit për Marrëdhënie me Publikun dhe Standardizim, dhe Benjamin Muça, këshilltar për mbështetje organizative.

Ata shpjeguan në detaje funksionimin e sistemit pensional me tre shtylla, mënyrën e akumulimit të mjeteve në llogaritë individuale dhe përfitimet nga pjesëmarrja në shtyllën e dytë dhe të tretë.

Pas prezantimit u zhvillua një kuiz njohurish, ku nxënësit iu përgjigjën me shumë interes pyetjeve në temë. Më të suksesshmit morën shpërblime simbolike nga MAPAS.



10 shtator 2025 – SHMT „Mihajlo Pupin“ – Shkup

Dita e dytë e fushatës u zhvillua në shkollën “Mihajlo Pupin”. Pas fjalës përshëndetëse të drejtorit, ligjëratën e udhëhoqën Marija Popovska, këshilltare kryesore e Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve të MAPAS, Engin Elmaz, udhëheqës i Sektorit për Marrëdhënie me Publikun dhe Standardizim, dhe Benjamin Muça, këshilltar për mbështetje organizative.

Nxënësit u njohën me konceptet kryesore si kursimi pensional vullnetar, roli i shoqërive pensionale dhe mundësitë për menaxhimin e mjeteve të veta.

Edhe këtë herë interesi ishte i madh – vijoi një garë kuizi me dhënie shpërblimesh për pjesëmarrësit më të shpejtë dhe më të saktë.



11 shtator 2025 – SHMP „Moša Pijade“ – Tetovë

Karvani edukativ i MAPAS-it vazhdoi në Tetovë, ku ngjarja kishte rëndësi të veçantë për shkak të pranisë së përfaqësuesve lokalë.

Fjalë përshëndetëse mbajtën Kryetari i Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it, Remzi Bajrami, dhe Kryetari i Komunës së Tetovës, Bilall Kasami, të cilët theksuan rëndësinë e edukimit pensional dhe stabilitetit financiar për gjeneratat e ardhshme.

Ligjëratën e mbajtën Pranvera Suma, këshilltare kryesore e Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it, Marija Popovska, këshilltare kryesore e Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve të MAPAS, Vlado Georgiev Udhëheqës i Sektorit për Kontroll Institucional, Engin Elmaz, udhëheqës i Sektorit për Marrëdhënie me Publikun dhe Standardizim, dhe Benjamin Muça, këshilltar për mbështetje organizative.

Përmes një qasjeje interaktive dhe diskutimi të hapur, nxënësit patën mundësi të parashtrojnë pyetje dhe të mësojnë më shumë për kursimin personal pensional. Në fund u zhvillua një kuiz me shpërblime që krijoi shumë energji pozitive dhe entuziazëm.



12 shtator 2025 – SHM „Kosta Susinov“ – Radovich

Ngjarjen në Radovich e hapi drejtori i shkollës me një fjalë përshëndetëse, pas së cilës vijoi ligjërata e mbajtur nga Suzana Zlatarevska, përgjegjëse për marketing në KB Shoqëria e Parë Pensionale Sh.A. Shkup dhe Svetlana Tasevska, përgjegjëse për marketing në VFP Shoqëria Pensionale Sh.A. Shkup. Ato paraqitën procesin e kursimit në fondet pensionale, mënyrën e investimit të mjeteve dhe mekanizmat e mbrojtjes së anëtarëve. Ngjarja përfundoi me kuiz njohurish dhe shpërndarje dhuratash për nxënësit më të suksesshëm.



14 shtator 2025 – Ngjarje në Parkun e Qytetit – Shkup

Në kuadër të aktiviteteve të fundjavës, MAPAS organizoi një ngjarje publike edukative në Parkun e Qytetit të Shkupit.

Ngjarjen e hapi Remzi Bajrami, Kryetar i Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it, i cili theksoi rëndësinë e sigurisë pensionale personale.

Për vizitorët u organizuan lojëra interaktive, ndër to më e pëlqyera ishte loja “Thesari i fshehur”, ku pjesëmarrësit në mënyrë argëtuese mësonin për konceptet e kursimit dhe investimit.

U mbajt edhe një kuiz me shpërblime, ndërsa punonjësit e MAPAS-it ishin në dispozicion për biseda individuale dhe sqarime rreth sigurimit pensional të financuar kapitalisht dhe funksionimit të sistemit pensional në vend.

Ngjarja tërhoqi shumë të rinj dhe familje që u njohën me temën në mënyrë edukative dhe argëtuese.



15 shtator 2025 – Ngjarja qendrore në SHMP „Zdravko Cvetkovski“ – Shkup

Fushata u përmbyll me ngjarjen qendrore në shkollën “Zdravko Cvetkovski” në Shkup. Para sallës së mbushur me nxënës, ngjarjen e hapi drejtoresha e shkollës me një fjalë përshëndetëse, e pasuar nga fjalimet e Remzi Bajramit, Kryetar i Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it, dhe Fatmir Sabriu, këshilltar shtetëror në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë. Ligjëratorin e mbajtën Pranvera Suma këshilltare kryesore e Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve të MAPAS dhe Marija Popovska, këshilltare kryesore e Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve të MAPAS, të cilat me shembuj praktikë shpjeguan se si vendimet financiare të sotme ndikojnë në të ardhmen dhe si kursimi i rregullt mund të sigurojë një pension të qetë dhe të sigurt. Edhe kjo ngjarje përfundoi me kuiz dhe shpërblime që nxitën interesin e nxënësve për të mësuar më shumë mbi temën.



Edukimi online dhe mbështetja mediatike

Përveç ngjarjeve fizike, MAPAS realizoi edhe një fushatë online në rrjetet sociale, me postime, infografikë dhe video që shpjegojnë thelbin e sigurimit pensional të financuar kapitalisht, procesin e kontributeve dhe mënyrën e menaxhimit të mjeteve.

Qëllimi ishte të arrihej një audiencë sa më e gjerë, veçanërisht të rinjtë që janë më aktivë në platformat digjitale, me mesazhin se kursimi nuk është shpenzim, por investim në të ardhmen tënde.

Me realizimin e kësaj fushate, MAPAS edhe njëherë dëshmoi përkushtimin e saj për ngritjen e vetëdijes për sigurimin pensional dhe edukimin financiar të të rinjtë.

Përmes komunikimit të drejtpërdrejtë dhe shembujve praktikë, nxënësit nga qytete të ndryshme fituan njohuri të vlefshme për ndikimin e vendimeve të përditshme financiare në të ardhmen e tyre. Me kulturë pensionale dhe kursim të përgjegjshëm sot, ndërtojmë një të ardhme të sigurt për nesër.

“

„Pensioni fillon kur
merr rrogën e parë.
Mos e prit momentin
e duhur – ai është tani.“

“

„Mos e humb kohën.
Investoje në
pensionin tënd“

MAPAS NË PARKUN E QYTETIT ME RASTIN E DITËS SË VETËDIJESIMIT PENSIONAL:
INFORMIM, ARGËTIM DHE SHPËRBLIME PËR TË PRANISHMIT

Në kuadër të shënimit të Ditës së vetëdijesimit pensional – 15 shtator, Agjencia për mbikëqyrjen të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS, më 14 shtator (e diel) nga ora 11:00 deri në 13:30, në pjesën e dytë të Parkut të Qytetit (përballë parkut për qen), do të organizojë një ngjarje ku të gjithë qytetarët do të kenë mundësi të informohen për të drejtat e tyre në sistemin pensional, si dhe të argëtohen dhe të fitojnë shpërblime.

“Është me rëndësi të veçantë që të gjithë qytetarët të kenë informata të sakta për funksionimin e sistemit pensional, si dhe për të drejtat dhe mundësitë e tyre brenda tij. Pikërisht për këtë arsye i ftojmë të gjithë të na bashkohen në këtë ngjarje, t’ua sqarojmë të gjitha paqartësitë dhe së bashku, në një atmosferë të këndshme dhe joformale, të shoqërohemi,” apelian nga MAPAS.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.

**DITA E
VETËDIJËSIMIT
PENSIONAL**

15 SHTATORI

14.09.2025 (e diel)
në orën 11:00
Parku i Qytetit
(pjesa e dytë – përballë parkut për qen)

Vizitoni faqet tona dhe ndiqni risitë vazhdimisht
www.mapas.mk | www.penzija.mk

KUVENDI I SHQIPËRISË
SAVA
triglav
WWP

Në kuadër të shënimit të Ditës së ndërgjegjësimit pensional – 15 Shtatori, Agjencia për Mbikëqyrjen e Financimit Kapital të Sigurimit Pensional – MAPAS sot në Parkun e qytetit organizoi një ngjarje për informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre në sistemin pensional. Qëllimi i ngjarjes, siç kumtoi MAPAS, është të gjithë qytetarët të kenë informata të sakta për funksionimin e sistemit pensional.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



MAPAS ME NGJARJE QENDRORE NË SGGUS “ZDRAVKO CVETKOVSKI” SHKUP ME RASTIN E DITA E VETËDIJËSIMIT PENSIONAL

Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional – MAPAS, me një sërë aktivitete të realizuara gjatë ditëve të kaluara, e shënoi Ditën së vetëdijesimit pensional – 15 shtator, ndërsa ngjarja qendrore, me edukim për të rinjtë, do të mbahet në SHMQShT “Zdravko Cvetkovski” – Shkup.

Në ngjarje do të mbajnë fjalë kryetari i Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it, Remzi Bajrami, dhe këshilltari shtetëror në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, Fatmir Sabriu.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



Në SGGUS “Zdravko Cvetkovski” në Shkup sot u mbajt ngjarja qendrore me rastin e shënimit të Ditës së vetëdijësimit pensional – 15 shtator, e organizuar nga Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS). Ngjarja iu kushtua të rinjve dhe edukimit të tyre për funksionimin e sistemit pensional, me qëllim që në moshë të hershme të krijohet kulturë e informimit dhe përgjegjësisë ndaj së ardhmes. Para nxënësve dhe profesorëve të pranishëm foli sekretari shtetëror në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, Fatmir Sabriu, i cili theksoi se vetëdijësimi pensional nuk është diçka e largët, por pjesë thelbësore e së tashmes.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



NJOFTIM PËR EDICIONIN E SHTATË TË SAMITIT DIGJITAL TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Përfaqësues nga Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS) morën pjesë në edicionin e shtatë të Samitit Digjital të Ballkanit Perëndimor, i cili u mbajt në Shkup.

Në ngjarje morën pjesë Kryetari i Këshillit të Ekspertëve, Remzi Bajrami, si dhe Këshilltaret kryesore të Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve, Pranvera Suma dhe Maria Popovska.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



Në periudhën nga 7 deri më 9 tetor 2025, në Sarajevë, u mbajt takimi vjetor i projektit rajonal për mbështetje teknike në fushën e edukimit financiar, i organizuar nga Banka Qendrore e Bosnjës dhe Hercegovinës, me mbështetje nga OECD/INFE dhe Ministria e Financave e Holandës.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



KENI PYETJE OSE ANKESA?
Paraqituni në MAPAS ose shkruani një mesazh në
contact@mapas.mk

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS)
Slavko Janevski 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Тел: (02) 3224 229
www.mapas.mk

